

Nr. 6 Regj

Durrës, më 20. 06. 2025

Lënda: Në përgjigje të kërkesës suaj.

Emër MBIEMËR

Adresa

Në kuadër të implementimit të Ligjit Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit” (i ndryshuar), si dhe në referencë të kërkesës suaj, datë 16.06.2025, me objekt “*Ecuria e punimeve të hekurudhorës: Durrës-Tiranë-Rinas*”, e regjistruar në regjistrin e “Kërkesë/Ankesë/Përgjigje” në përputhje me nenin 8 të ligjit të sipërcituar me Nr. 6, ju informojmë për si vijon:

1. Në çfarë faze janë aktualisht punimet për hekurudhën Tiranë-Durrës-Rinas?

Punimet ndërtimore për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore Durrës-Tiranë (PTT) kanë arritur masën në 86 % duke përfshirë këtu dhe ndërtimin e trasesë së re prej 5 km në drejtim të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës (TIA). Punimet pritet civile te trasesë hekurudhore të përfundojnë brenda muajit Shtator 2025 (Kontrata e Pare).

2. A ka nisur puna për ndërtimin e stacioneve të reja të hekurudhës?

Ndërtimi i Godinave të Stacioneve hekurudhore dhe të sistemimit të shesheve të jashtme është një kontratë e re (Kontrata e dyte) në funksion të Projektit “Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore Durrës-Terminali i Transportit Publik Tiranë (PTT) dhe lidhja me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (TIA)”. Kjo kontratë me dt. 5 Qershor 2025 ka nisur punimet ndërtimore dhe parashikohet të zgjasë 12 muaj. Aktualisht janë shembur të gjithë stacionet e vjetra dhe ka nisur puna për t’u ndërtuar të reja nga Kontraktori i ri i punimeve (shoqeria austriake STRABAG).

3. Cila është planvendosja e stacionit të planifikuar në Rinas dhe në çfarë faze ndodhen punimet në këtë stacion?

Stacioni fundor i Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës (TIA) do të ndërtohet përballë Forcave të Armatosura Ajrore. Lidhur me këtë ka përfunduar ndërtimi i trasesë së re hekurudhore nga ana e

kontraktorit të parë (INC). Ndërsa Stacioni hekurudhor është objekt i kontratës së “Ndërtimit të Godinave të Stacioneve Hekurudhore”-Kontrata e dyte.

4. Cilat janë pritshmëritë e projektit për vitin 2025?

Deri në fund të vitit 2025 pritet të përfundojë kontrata e parë e ndërtimit të Linjës Hekurudhore (Trase) , ndërsa kontrata e dytë ajo e Godinave deri në fund të vitit pritet të ketë arritur në masën 50% të punimeve. Kontrata e trete, ajo e ndertimit te elektrifikimit te linjes hekurudhore, pritet te hapet tenderi nderkombetar brenda tremujorit te fundit te viti 2025, ku gjithashtu pritet dhe nenshkrimi i kontrates dhe nisja e punimeve.

5. Kur pritet të nis udhëtimi i qytetarëve?

Ky është një angazhim i cili i takon vendimmarrjes së Qeverisë Shqiptare mbi operimin e Trenave. Megjithkëtë në fund të vitit 2026 linja është plotësisht gati për operim, ku te tre kontratat (linja, godinat dhe elektrifikimi) priten te perfundojen brenda vitit 2026.

**Autoriteti publik “Hekurudha Shqiptare” Sh.A, angazhohet në garantimin e të drejtës së informimit, si garanci kushetuese dhe vepron në mbështetje të ligjit Ligjit Nr. 119/ 2014 “Për të Drejtën e informimit” dhe trajton kërkesën tuaj në përputhje me Ligjin nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.*

Me konsideratë!

KOORDINATORI I TË DREJTËS SË INFORMIMIT
Domeniko SINJARI